



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:044712

Datë: 27.09.2023

Numri i dokumentit: 04723887

C-III-13-0061

*Paditësi:*

**G D**, Klinë  
të cilin e përfaqëson Av. H P nga Klina.

*Kundër*

*E Paditura:*

**NPB ‘‘Malishgan’’** – përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**,  
Rr.’’ Dritan Hoxha nr.55 , Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga gjyqtarët Shkelzen Sylaj kryesues, Sylejman Shumolli dhe Diellza Hoxha gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 27 shtator 2023, lëshon këtë:

### **A K T V E N D I M**

- 1. Hedhet poshtë si e papranueshme padia e paditësit G N D me të cilën ka kërkuar që ai të shpallet pronar i njësisë P-71006024- 00093-60, vendi i quajtur K, me sipërfaqe prej 5164 m2 dhe njësisë P-71006024-00093-61, vendi i quajtur K, me sipërfaqe prej 1153, Zona Kadastrale Klinë.**
- 2. Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

### **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 14 shkurt 2013, paditësi ka parashtruar padi për vërtetimi e pronësisë për ngastrat kadastrale nr. 93-60, në vendin e quajtur K me sipërfaqe prej 0,51.64 ha dhe ngastrën 93-61 në vendin e

quajtur K në sipërfaqe 0,11.53 ha, Zona kadastrale Klinë. Ka theksuar se babai i tij N D sa ishte në jetë me 21 prill 1971 me kontratë për shitblerje i ka blerë ngastrat e lartcekura nga S M. Ka shtuar se ngastrat në fjalë i ka në shfrytëzim të qetë dhe i mban pa u penguar nga askush. Shitësi S M ngastrat e lartcekura i ka ndërruar me disa ngastra tjera të cilat i kishte blerë shumë vite me parë nga S S. Padiësi i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj si të bazuar padinë e tij dhe të vërtetohet se ai pronar i ngastrave kadastrale duke e detyruar të paditurën që t'ia mundësoj bartjen e pronësisë në emër të tij. Padiësi si dëshmi ka bashkangjitur kontratën e shitblerjes të dt. 21 prill 1971, njoftimi i bërë tek AKP-ja lidhur me ngritjen e padisë në gjykatë dt. 04 dhjetor 2012, autorizimin e avokatit për përfaqësim, fletën poseduese në emër të NPB "Malishgan".

Me 01 mars 2016 e paditura – AKP, ka parashtruar mbrojtje në padi dhe e ka kundërshtuar padinë e padiësit në tersi si të pa bazuar në ligj. Ka theksuar se padiësi e ka parashtruar padinë në kundërshtim me parimin procedural – i cili ka të bëjë me legjitimitetin aktiv të palës, duke theksuar se padiësi nuk e ka bashkangjitur aktvendimin e trashëgimisë me të cilën do të dëshmohej se ai është pasardhës i tani të ndjerit N D. Padiësi nuk ka theksuar bazën juridike me të cilën e mbështet padinë e tij. Padiësi gjithashtu nuk e ka kërkuar me herët pronën e tij, pra padiësi ka qenë pasiv dhe i pa interesuar në drejtim të fitimit të pronësisë mbi ngastrat kontestuese. Pretendimi i padiësit se nga vitit 1971 e ka paguar çmimin për ngastra kontestuese dhe se ka hyre në posedim të sendit të blere është i pa qëndrueshëm dhe pa mbështetje ligjore, nga fakti se padiësi nuk ka prezantuar dëshmi të besueshme për transaksion të ligjshëm të patundshmërisë.

Gjithashtu në bazë të nenit 268 (GZ- RSFJ 53/65 i ligjit të punës së bashkuar) parasheh: po edhe nëse ekzistojnë pretendimet e padiësit nëse pasuria e paluajtshme është bërë pasuri publike pa bazë ligjore, padiësi kthimin e saj mund ta kërkoj brenda në një periudhë prej pesë viteve nga data se kur është mësuar për të por jo me shumë se dhjetë vite nga ai fakt. Nga kjo rrjedh se padia e padiësit është e pas afatshme. AKP i ka pa propozuar gjykatës që ta hedh poshtë si të pa bazuar padinë e padiësit.

Me 12 nëntor 2015, padiësi përmes një parashtrëse e ka plotësuar padinë duke i dorëzuar gjykatës një vendim mbi Arondimin ndërrimin e pronave private me ato shoqërorë të datës 24 qershor 1971 numër 04-3902, duke shtuar se S M ju kishte marr parcela numër 1/35 me sipërfaqe prej 63.17 ha nga NPB "Malishgan" dhe si kompensim për këtë parcele të njëjtit iu kishte dhënë parcela nr. 93/61 dhe parcelën 93/60. Padiësi ka bashkangjitur parashtrësen aktvendimin në fjalë.

Me 16 maj 2023 padiësi ka parashtruar kërkesë për caktimin e masës së sigurisë për ngastrën kadastrale numër 93/60, në sipërfaqe prej 5164 m2 dhe ngastrën 93/61 me sipërfaqe prej 1153 m2, ZK- Klinë.

Me 09 qershor 2023, AKP-ja ka parashtruar përgjigje në kërkesën e padiësit për caktimin e masës së sigurisë dhe ka kundërshtuar pretendimet e padiësit të paraqitura në padi dhe në kërkesë për masë të sigurisë. AKP i ka propozuar gjykatës që kërkesën për masë të sigurimit, ta refuzoj si të pa bazuar.

Me 15 qershor 2023, Gjykata ka refuzuar kërkesën e padiësit për caktimin e masës së sigurimit.

Me 15 qershor 2023, Gjykata lëshoj urdhrë për paditësin, me anë të së cilit kërkoi që të parashtrijë në gjykatë dëshmi vendimin e trashëgimisë, për të vërtetuar legjitimitetin real aktiv të palës paditëse. Paditësi është njoftuar se nëse nuk e përmbushin urdhrin, atëherë padia e tij do të hedhet poshtë si e pa pranueshme.

Me 04 korrik 2023, paditësi përmes përfaqësuesit të tij dorëzoi në gjykatë, një certifikatë vdekjes për paraardhësin e tij N D, dëshmi vdekjen dhe një certifikatë të lindjes për paditësin.

### **Arsyetimi Ligjor**

Padia e paditësit hedhet poshtë si e papranueshme.

Në kuptim të nenit 76.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktvendim pa caktuar seancë dëgjimore.

Një nder kushtet themelore procedurale që një padi të jetë e vlefshme është legjitimiteti i palës për të vepruar.

Në rast të një kërkese padie në lidhje me të drejta mbi një pasuri të trashëguara siç pretendon paditësi, Gjykata duhet të shqyrtoj edhe ex officio nëse të gjithë trashëgimtarët janë të përfaqësuar. Por tek ky rast edhe e paditura e kontestuar legjitimitetin aktiv që nga fillimi dhe paditësi nuk e ka provuar atë. Aktvendimi i trashëgimisë është i vetmi dokument për të treguar dëshmuar në mënyrë të mjaftueshëm pozitën e trashëgimtarëve.

Gjykata me urdhrin e datës 15 qershor 2023, kërkoi nga paditësi që të dorëzonte vendimin e trashëgimisë, në mënyrë që të dëshmohet legjitimiteti aktiv i palës në procedurë, i cili është veprim i para procedurale që gjykata duhet ndërmerr para se të shkohet në çështjen kryesore. Gjykata përmes urdhrin e njoftoi paditësin për pasojat në rast të mos përmbushjes së urdhrin.

Me 04 korrik 2023, paditësi përmes përfaqësuesit të tij dorëzoi në gjykatë, një certifikatë vdekjes për paraardhësin e tij N D, dëshmi vdekjen dhe një certifikatë të lindjes. Ka shtuar se përmes këtyre dëshmive vërtetohet se paditësi është i vetmi trashëgimtar i të ndjerit N D, meqë i ndjeri nuk ka lënë pasuri trashëgimore të regjistruar në emër të tij.

Gjykata konstaton se dëshmitë e dorëzuara nga paditësi në bazë të nenit 171.1 lidhur me 178.1 të ligjit të Procedurës jo kontestimore, nuk janë të mjaftuara pasi që në bazë të këtyre dispozitave kërkohet aktvendimi i trashëgimisë.

Kjo tashmë rezulton se paditësi nuk e ka dëshmuar faktin se ai është trashëgimtar dhe i vetmi trashëgimtar të paraardhësit të tij të ndjerit N D. Gjykata nuk mundet thjesht të supozojë se kështu është gjendja dhe kjo nuk dëshmohet me dëshmi vdekjeje, certifikatën e vdekjes apo certifikatën e lindjes, por kjo duhet të dëshmohet me aktvendimin e trashëgimisë.

Meqë paditësi nuk e ka provuara legjitimitetin aktiv sepse trashëgimia nuk është dëshmuar, paditësi duke marrë parasysh se një ditë do të dëshmojë pozitën e tij si trashëgimtarë me anë të aktvendimit të trashëgimisë, ai mund të paraqesin një padi të re.

Andaj në bazë të të lartë cekurave, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Për këtë, në pajtim me nenet 36 par.1 dhe par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, padia e paditësit hedhet poshtë si e papranueshme.

### **Shpenzimet Gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar Kryesues

Sylejman Shumolli, Gjyqtar

Diellza Hoxha, Gjyqtare